

L I G J
Nr.8264, datë 18.12.1997

**PËR RATIFIKIMIN E "MARRËVESHJES PLOTËSUESE PËR PROTOKOLLIN E
NDIHMËS DHE TË BASHKËPUNIMIT TË FORCAVE TË ARMATOSURA NDËRMJET
MINISTRISË SË MBROJTJES TË SHQIPËRISË DHE MINISTRISË SË MBROJTJES
KOMBËTARE TË GREQISË"**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet "Marrëveshja plotësuese për protokollin e ndihmës dhe të bashkëpunimit të Forcave të Armatosura ndërmjet Ministrisë së Mbrojtjes të Shqipërisë dhe Ministrisë së Mbrojtjes Kombëtare të Greqisë", e arritur në kuadrin e programit individual të partneritetit për paqe ndërmjet NATO-s dhe Republikës së Shqipërisë.

Neni 2

Çdo ndryshim i kohëqendrimit dhe numrit të forcës së kufizuar greke në Shqipëri miratohet nga Kuvendi Popullor me propozim të Këshillit të Ministrave.

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.1975, datë 23.12.1997 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Rexhep Meidani**